



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Nr.135

7 tetor

2010

P Ë R M B A J T J A

Faqe

Ligj nr.10 315 datë 16.9.2010	Për miratimin e aktit normativ, me fuqinë e ligjit, nr.4, datë 25.8.2010, të Këshillit të Ministrave “Për disa ndryshime në ligjin nr.10 119, datë 23.4.2009 “Për planifikimin e territorit”, të ndryshuar”.....	7407
Ligj nr.10 317 datë 16.9.2010	Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, të ndryshuar...	7407
Ligj nr.10 318 datë 16.9.2010	Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.9720, datë 23.4.2007 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”	7416
Ligj nr.10 319 datë 16.9.2010	Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8405, datë 17.9.1998 “Për urbanistikën”, të ndryshuar.....	7421
Vendim i KM nr.792, datë 6.10.2010	Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.383, datë 19.5.2010 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e procedurave të shpërndarjes së fondit të kompensimit në vlerë për pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimet informale”.....	7424
Udhëzim i MF dhe MASH nr.17, datë 10.5.2010	Për pensionet shtetërore suplementare të punonjësve të universiteteve, të shkollave të larta, Qendrës së Studimeve Albanologjike, Akademisë së Shkencave dhe të gjitha insitucioneve të tjera kërkimore publike në Republikën e Shqipërisë, të cilët kanë tituj.....	7425
Urdhër i MPPT, MB dhe MF nr.2815/2, datë 16.8.2010	Për kufijtë e rinj të masave administrative me gjobë.....	7428

LIGJ
Nr.10 315, datë 16.9.2010

**PËR MIRATIMIN E AKTIT NORMATIV, ME FUQINË E LIGJIT, NR. 4, DATË 25.8.2010,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 10 119,
DATË 23.4.2009 “PËR PLANIFIKIMIN E TERRITORIT”, TË NDRYSHUAR”**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 101 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Miratohet akti normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 4, datë 25.8.2010, i Këshillit të Ministrave “Për disa ndryshime në ligjin nr.10 119, datë 23.4.2009 “Për planifikimin e territorit”, të ndryshuar”.

**Shpallur me dekretin nr.6695, datë 4.10.2010 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi**

LIGJ
Nr.10 317, datë 16.9.2010

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 9121, DATË 28.7.2003 “PËR
MBROJTJEN E KONKURENCËS”, TË NDRYSHUAR¹**

Në mbështetje të neneve 78 e 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Në nenin 2 pika 1, pas shkronjës “b” shtohen shkronjat “c” dhe “ç” me këtë përmbajtje:

1. I përafuar plotësisht me:

- Nenet 101 – 106 të Traktatit mbi Funkcionimin e Bashkimit Europian (TFBE) Gazeta Zyrtare e Bashkimit Europian, Seria C 115, datë 9.5.2008, fq 47 – 199.
- 32003R0001, Rregullorja e Këshillit 1/2003/KE, datë 16 dhjetor 2002 “Mbi Implementimin e Rregullave të Konkurrencës të parashikuara në nenet 81 dhe 82 të Traktatit të KE-së”, Gazeta Zyrtare e Bashkimit Europian, Seria L 1, datë 4.1.2003, fq. 1 – 25.
- 32004R0139, Rregullorja e Këshillit 139/2004/KE, datë 20 janar 2004 “Mbi Kontrollin e Përqendrimeve të Ndërmarrjeve”, Gazeta Zyrtare e Bashkimit Europian, Seria L 24, datë 29.1.2004, fq. 1 – 22.

“c) ndërmarrjet publike dhe ndërmarrjet, të cilave u janë dhënë nga shteti të drejta ekskluzive ose të drejta të veçanta;

ç) ndërmarrjet, të cilave u është dhënë e drejta e ushtrimit të veprimtarisë në fushën e shërbimeve me interes ekonomik të përgjithshëm apo ato, të cilat kanë karakterin e monopoleve të orientuara drejt sigurimit të të ardhurave, për sa kohë dhe në atë masë që në ligj dhe në fakt nuk pengohet veprimtaria e tyre.”.

Neni 2

Në nenin 3, pikat 4 e 5 ndryshohen si më poshtë:

“4. “Marrëveshje” janë marrëveshjet dhe/ose praktikat e bashkërenduara ndërmjet dy apo më shumë ndërmarrjeve, si dhe vendimet ose rekomandimet e grupimeve të ndërmarrjeve, pavarësisht nga forma, e shkruar ose jo, apo nga forca detyruese e tyre.

5. “Pozitë dominuese” është ajo fuqi ekonomike e mbajtur nga një ose më shumë ndërmarrje, që i jep atyre mundësinë për të penguar konkurrencën efektive në treg, duke i bërë ato të afta të veprojnë, për sa i takon ofertës ose kërkesës, në mënyrë të pavarur nga pjesëmarrësit e tjerë në treg, si konkurrentët, klientët ose konsumatorët.”.

Neni 3

Në nenin 4 pika 1, shkronja “ç” ndryshohet si më poshtë:

“ç) në marrëdhëniet tregtare me palët e tjera, zbatojnë kushte të ndryshme për transaksione të njëjta, duke i vendosur ato në gjendje të pafavorshme konkurrence.”.

Neni 4

Neni 5 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 5

Përfashtimi individual i marrëveshjeve

Mund të përfashtohet nga zbatimi i pikës 1 të nenit 4 çdo marrëveshje, e cila kontribuon në përmirësimin e prodhimit ose të shpërndarjes së produkteve ose në nxitjen e progresit teknologjik apo ekonomik, nëse një pjesë e mjaftueshme e këtyre përfitimeve shkon në favor të klientëve e të konsumatorëve dhe kur:

1. Nuk përmban kufizime të veprimtarive të ndërmarrjeve pjesëmarrëse, që nuk janë të domosdoshme për të arritur objektivat e sipërpërmendur;

2. Nuk kufizon, në mënyrë të ndjeshme, konkurrencën në lidhje me produktet apo shërbimet, objekt i këtyre marrëveshjeve.”.

Neni 5

Neni 6 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 6

Përfashtimi i kategorive të marrëveshjeve

Komisioni miraton rregullore për kategoritë e marrëveshjeve që përfashtohen nga ndalimi i parashikuar në pikën 1 të nenit 4. Në këto rregullore përcaktohen me hollësi kushtet që duhet të përmbushin marrëveshjet, për të përfituar nga përfashtimi i ndalimit të parashikuar në pikën 1 të nenit 4.”.

Neni 6

Neni 7 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 7

Marrëveshjet me rëndësi të vogël

Mund të përjashtohen nga zbatimi i pikës 1 të nenit 4 ato marrëveshje, të cilat nuk e kufizojnë ndjeshëm konkurrencën në treg, në rast se pjesa e tregut e të gjitha ndërmarrjeve së bashku, pjesëmarrëse në këtë marrëveshje, nuk tejkalon:

- a) 10 për qind të tregut përkatës, ku pjesëmarrësit janë konkurrentë aktualë ose potencialë;
- b) 15 për qind të tregut përkatës, ku pjesëmarrësit nuk janë konkurrentë aktualë ose potencialë.”.

Neni 7

Neni 9 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 9

Abuzimi me pozitën dominuese në treg

1. Ndalohet çdo abuzim me pozitën dominuese nga një ose më shumë ndërmarrje, që e zotërojnë këtë pozitë në treg.

2. Mund të përbëjnë abuzim me pozitën dominuese veçanërisht:

- a) vendosja, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, e çmimeve të padrejta të blerjes ose shitjes apo e kushteve të tjera të padrejta të tregtimit;
- b) kufizimi i prodhimit, tregjeve ose zhvillimit teknik;
- c) zbatimi i kushteve të pabarabarta për veprime tregtare të njëjta me palët, duke i vendosur ato në gjendje të pafavorshme konkurrence;
- ç) vendosja e kushteve për lidhjen e kontratave me palët e tjera, që këto të fundit të pranojnë detyrime shtesë, të cilat, për vetë natyrën e tyre ose sipas praktikave tregtare, nuk kanë lidhje me objektin e kontratave në fjalë.”.

Neni 8

Neni 10 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 10

Përqendrimi i ndërmarrjeve

1. Përqendrim të ndërmarrjeve kemi në rastet kur shkaktohet një ndryshim i qëndrueshëm i kontrollit, si rrjedhojë e:

- a) bashkimit të dy ose më shumë ndërmarrjeve ose pjesë ndërmarrjesh të pavarura nga njëra-tjetra;
- b) përfitimit të kontrollit të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, nga një ose më shumë persona fizikë, të cilët njëkohësisht kanë kontrollin e të paktën një ndërmarrjeje tjetër ose nga një ose më shumë ndërmarrje, mbi një ose më shumë ndërmarrje, ose të një pjese të këtyre të fundit, përmes blerjes së aksioneve, kuotave apo asetëve, kontratës ose çdo mjeti tjetër të ligjshëm;
- c) kontrollit të drejtpërdrejtë ose të tërthortë mbi një ose më shumë ndërmarrje ose të një pjese të këtyre të fundit.

2. Kontrolli, sipas shkronjës “b” të pikës 1 të këtij neni, mund të përfitohet nëpërmjet të drejtave, kontratave ose çdo mënyre tjetër, të cilat, më vete ose të kombinuara dhe, duke marrë parasysh rrethanat e faktit ose të ligjit, krijojnë mundësinë e ushtrimit të një ndikimi vendimtar mbi veprimtarinë ekonomike të një ndërmarrjeje, në veçanti, me anë të:

a) së drejtës së pronës ose të së drejtës për të përdorur të gjitha ose një pjesë të aktiveve të një ndërmarrjeje;

b) të drejtave ose kontratave, që ndikojnë në mënyrë të ndjeshme në përbërjen, votimin ose vendimet e organeve drejtuese të një ndërmarrjeje.

3. Krijimi i një ndërmarrjeje të përbashkët nuk përbën një përqendrim, sipas këtij neni, në rast se ka për objekt apo pasojë bashkërendimin e veprimtarive konkurruese ndërmjet dy ose më shumë ndërmarrjesh të pavarura. Në këtë rast, krijimi i një ndërmarrjeje të përbashkët vlerësohet në bazë të nenit 4 të këtij ligji.”.

Neni 9

Neni 12 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 12

Kontrolli i përqendrimeve

1. Përqendrimet e ndërmarrjeve njoftohen në Autoritet për të marrë autorizim, nëse, në vitin e fundit financiar, para përqendrimit:

a) xhiroja e të gjitha ndërmarrjeve pjesëmarrëse së bashku në tregun ndërkombëtar është më shumë se 7 miliardë lekë dhe xhiroja e të paktën një ndërmarrjeje pjesëmarrëse, në tregun e brendshëm, është më shumë se 200 milionë lekë.

b) xhiroja e të gjitha ndërmarrjeve pjesëmarrëse së bashku në tregun e brendshëm është më shumë se 400 milionë lekë dhe xhiroja e të paktën një ndërmarrjeje pjesëmarrëse, në tregun e brendshëm, është më shumë se 200 milionë lekë.

2. Përqendrimet e parashikuara në pikën 1 të këtij neni njoftohen brenda 30 ditëve nga lidhja e marrëveshjes për bashkim, për përfitim kontrolli ose për krijimin e një ndërmarrjeje të përbashkët, me karakteristikat e parashikuara në pikën 3 të nenit 10 të ligjit, si dhe nga publikimi i ofertës publike për blerje ose shkëmbim.

3. Ndërmarrje pjesëmarrëse, në kuptimin e këtij neni, janë:

a) në rast bashkimi, ndërmarrjet që bashkohen;

b) në rast përfitimi kontrolli, ndërmarrjet dhe/ose personat e parashikuar në shkronjën “b” të pikës 1 të nenit 10, që përftojnë kontrollin, dhe ndërmarrjet ose pjesët e ndërmarrjeve, që bëhen objekt të përfitimit të kontrollit;

c) në rast krijimi të një ndërmarrjeje të përbashkët, sipas pikës 3 të nenit 10, ndërmarrjet që kanë kontrollin e ndërmarrjes së përbashkët.”.

Neni 10

Neni 13 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 13

Vlerësimi i përqendrimit

1. Komisioni ndalon përqendrimet e ndërmarrjeve, që kufizojnë, në mënyrë të ndjeshme, konkurrencën në treg ose në një pjesë të tij, në veçanti, si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese.

2. Komisioni, në vlerësimin e përqendrimeve, mund të marrë, gjithashtu, parasysh, eficientat ekonomike që mund të rrjedhin nga përqendrimi, nëse plotësohen të gjitha kushtet e mëposhtme:

a) eficientat në fjalë kontribuojnë në rritjen e mirëqenies së konsumatorëve ose, të paktën, neutralizojnë efektet e mundshme negative që mund të sillte përqendrimi;

b) eficencat ekonomike janë ose do të jenë rezultat i përqendrimit nën shqyrtim dhe, për krijimin e tyre, nuk ekzistojnë mënyra alternative më pak antikonkurruese, se përqendrimi në fjalë;

c) eficientat ekonomike duhet të jenë të verifikueshme.

3. Komisioni, në raste të veçanta, mund të mos ndalojë përqendrimet, kur njëra nga ndërmarrjet pjesëmarrëse rrezikon seriozisht të falimentojë e nuk ka mundësi tjetër më pak antikonkurruese se realizimi i përqendrimit nëse:

a) ndërmarrja ndodhet në një situatë të tillë që, pa këtë përqendrim, duhet të dalë nga tregu në një të ardhme të afërt;

b) nuk ka mundësi për riorganizimin e veprimtarisë së kësaj ndërmarrjeje.”.

Neni 11

Në nenin 21, pas pikës 3 shtohet pika 3/1 me këtë përmbajtje:

“3/1. Tre muaj para përfundimit të mandatit të çdo anëtari të komisionit, autoriteti njofton me shkrim Kuvendin, i cili fillon praktikat për zgjedhjen e anëtarit të ri. Në rastet kur mandati i anëtarit të komisionit ka përfunduar dhe nuk është realizuar emërimi i anëtarit të ri, anëtari i vjetër qëndron në detyrë deri në zëvendësimin e tij.”.

Neni 12

Në nenin 24, pas shkronjës “g” shtohet shkronja “gj” me këtë përmbajtje:

“gj) përcakton përparësitë e hetimeve dhe afatet përkatëse për to.”.

Neni 13

Në nenin 27 pika 2, fjala “punonjësit” zëvendësohet me fjalën “nëpunësit”.

Neni 14

Pas nenit 29 shtohet neni 29/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 29/1

Trajtimi i ankesave

Palë të treta ose të interesuara për çështje që lidhen me kufizime, shtrembërime ose pengime të konkurrencës, paraqesin pranë Autoritetit të Konkurrencës ankesa a njoftime për këto konstatime. Autoriteti ruan dhe garanton mbetjen anonim të ankuesit, sa herë që ky i fundit e kushtëzon një gjë të tillë.

Ankesat ose njoftimet, pavarësisht nga mënyra e paraqitjes, pasi shënohen në regjistrin e protokollit, përcillen për trajtim profesional, brenda një afati të përcaktuar, në sekretariatit e Autoritetit. Procedurat e trajtimit të ankesave përcaktohen në rregulloren e funksionimit të Autoritetit.”.

Neni 15

Në nenin 33 bëhen këto ndryshime:

a) Pika 1 ndryshohet si më poshtë:

“1. Në çdo kohë, Autoriteti, me anë të një kërkesë të sekretariatit ose të komisionit, mund t’u kërkojë të tretëve, ndërmarrjeve ose grupimeve të ndërmarrjeve, t’i sigurojnë të gjitha informacionet e nevojshme, për zbatimin e këtij ligji, përfshirë edhe ato, të cilat përmbajnë sekrete tregtare.”.

b) Pika 4 shfuqizohet.

Neni 16

Në nenin 35 pika 3, emërtimi “Policisë Tatimore” zëvendësohet me emërtimin “Policisë së Shtetit”.

Neni 17

Neni 41 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 41

Hetimi në sektorët e ekonomisë

1. Autoriteti, me nismën e tij, me kërkesën e Kuvendit ose me kërkesën e institucioneve rregullatore të sektorëve përkatës, mund të kryejë një hetim të përgjithshëm në një sektor të ekonomisë, nëse ngurtësia e çmimeve ose rrethana të tjera të bëjnë të mendosh se konkurrenca në treg kufizohet ose shtrembërohet.

2. Autoriteti mund t’u kërkojë ndërmarrjeve ose grupimeve të ndërmarrjeve që t’i sigurojnë të gjitha informacionet e nevojshme për kryerjen e hetimit.

3. Autoriteti mund të publikojë një raport për rezultatet e hetimit të përgjithshëm në një sektor të ekonomisë, si dhe mund të ftojë palët e interesuara të shprehen për rezultatet e hetimit.

4. Parashikimet e neneve 33 e 34 të këtij ligji zbatohen edhe për pikën 2 të këtij neni.”.

Neni 18

Neni 42 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 42

Hetimi paraprak

1. Sekretariati, me miratimin e komisionit, mund të fillojë hetimin paraprak, me nismën e tij, me ankesë të palëve të interesuara ose të treta, për kufizime, shtrembërime apo pengime të konkurrencës. Sekretariati fillon hetimin paraprak, sa herë që kërkohet nga komisioni.

2. Gjatë hetimit paraprak nuk nënkuptohet e drejta për të konsultuar dosjet.

3. Autoriteti ruan mbetjen anonim të ankuesit, sa herë që ky i fundit e paracakton një gjë të tillë.”.

Neni 19

Neni 43 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 43

Hetimi i thelluar

1. Kur vihen re shenja të kufizimit të konkurrencës, fillohet procedura e hetimit të thelluar. Komisioni merr vendim për fillimin e procedurës së hetimit të thelluar dhe përcakton hapat për realizimin e tij. Vendimi zbatohet nga sekretariati i komisionit.

2. Afati i përfundimit të procedurave të hetimit të thelluar është deri në 6 muaj nga data e vendimit të komisionit për hapjen e hetimit të thelluar.

3. Afati, sipas pikës 2 të këtij neni, mund të zgjatet me vendim të komisionit, në rast se kërkohen hetime të mëtejshme, që kanë të bëjnë me prova, të dhëna shtesë dhe ekspertizë të specializuar për shqyrtimin e rastit.

4. Procedurat hetimore, të parashikuara në nenet 41, 42 e 43 të këtij ligji, kryhen sipas rregulloreve të dala në zbatim të këtij ligji.

5. Komisioni shprehet me vendim për mbylljen e hetimit, në zbatim të neneve 41, 42, e 43 të këtij ligji, edhe në rastet kur nuk konstatohen shenja të kufizimeve të konkurrencës.”.

Neni 20

Në nenin 49 bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Pika 1 ndryshohet si më poshtë:

“1. Në zbatim të nenit 5 të këtij ligji, ndërmarrjet ose grupimet e ndërmarrjeve njoftojnë në Autoritet marrëveshjet dhe ndryshimet e bëra në to.”.

2. Pika 3 ndryshohet si më poshtë:

“3. Njoftimi i dhënë Autoritetit, sipas kërkesës së pikave 1 e 2 të këtij neni, nuk duhet të përmbajë të dhëna të pasakta, të cilat bëhen shkak për të siguruar përjashtimin për palën njoftuese ose për një palë të tretë, sipas nenit 5 të këtij ligji.”.

3. Pas pikës 3 shtohet pika 4 me këtë përmbajtje:

“4. Ky nen nuk zbatohet për përjashtimin e kategorive të marrëveshjeve, të parashikuara në nenin 6 të këtij ligji.”.

Neni 21

Neni 50 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 50

Vendimi për përjashtime individuale

1. Marrëveshjet e njoftuara në bazë të nenit 49 të këtij ligji përjashtohen nga ndalimi i parashikuar në nenin 5 vetëm me vendim të komisionit.

2. Efektet e përjashtimit fillojnë nga data e njoftimit. Përjashtimet, sipas nenit 5 të këtij ligji, janë të kufizuara në kohë dhe mund t'u jepen ndërmarrjeve me kushte dhe detyrime.

3. Nëse me vendim të komisionit refuzohet përjashtimi nga ndalimi, komisioni nuk mund të vendosë gjoba për shkeljet e shkaktuara nga kjo marrëveshje, për periudhën gjatë së cilës ajo shqyrtohet. Komisioni i konkurrencës nuk mund të vendosë gjoba për ato ndërmarrje, të cilat kanë njoftuar marrëveshjen për periudhën nga data e njoftimit deri në marrjen e vendimit mbi përjashtimin ose jo të zbatimit të nenit 5 të këtij ligji.

4. Në bazë të një kërkesë, përjashtimet mund të shtyhen në kohë, nëse kushtet e përcaktuara në nenin 5 të këtij ligji vazhdojnë të plotësohen. Shtyrja mund të jepet vetëm për ndërmarrjet pjesëmarrëse, të cilat deklarojnë pëlqimin e tyre me shkrim pranë Autoritetit. Deklarata bëhet në mënyrë të pavarur nga çdo ndërmarrje dhe pranohet brenda 3 muajve para mbarimit të afatit të përjashtimit.

5. Ky nen nuk zbatohet për përjashtimin e kategorive të marrëveshjeve të parashikuara në nenin 6 të këtij ligji.”.

Neni 22

Në nenin 52 pika 2, fjalët “nenet 5, 6 dhe 7” zëvendësohen me fjalët “nenet 5 dhe 6”.

Neni 23

Neni 53 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 53
Detyrimi për njoftim

1. Kanë detyrimin për njoftim:
 - a) ndërmarrjet pjesëmarrëse në bashkim;
 - b) ndërmarrjet që marrin nën kontroll të gjithë ose pjesë të një ose më shumë ndërmarrjeve të tjera;
 - c) në rast krijimi të një ndërmarrjeje të përbashkët, sipas pikës 3 të nenit 10, ndërmarrjet që kanë kontrollin e ndërmarrjes së përbashkët.
2. Njoftimi që paraqet formën e përqendrimit kryhet në bazë të udhëzimit të nxjerrë nga Autoriteti për formën e njoftimit.”.

Neni 24

Në nenin 55, pas pikës 2 shtohet pika 3 me këtë përmbajtje:
“3. Nenet 33, 35 e 36 të këtij ligji zbatohen në veprimtaritë e Autoritetit, të parashikuara në pikat 1 e 2 të këtij neni.”.

Neni 25

Në nenin 56 bëhen këto ndryshime:

1. Pika 1 ndryshohet si më poshtë:
 - “1. Në rast se përqendrimi nuk shfaq shenja të kufizimit në mënyrë të ndjeshme të konkurrencës në treg ose në një pjesë të tij, në veçanti, si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese, komisioni vendos të autorizojë përqendrimin brenda 2 muajve nga data e marrjes së njoftimit.
Nëse konstatohet se përqendrimi shfaq shenja të tilla, komisioni vendos:
 - a) autorizimin e përqendrimit me kushte dhe detyrime;
 - b) fillimin e procedurës së thelluar.”.
 2. Fjalja e parë e pikës 2 ndryshohet si më poshtë:
“Në rastin e autorizimit me kushte dhe detyrime, afati i përcaktuar në pikën 1 të këtij neni shtyhet me dy javë, nëse ndërmarrjet pjesëmarrëse angazhohen të marrin masa për eliminimin e kufizimit në mënyrë të ndjeshme të konkurrencës në treg ose në një pjesë të tij, në veçanti, si rezultat i shenjave të krijimit ose të forcimit të pozitës dominuese.”.

Neni 26

Në nenin 57 bëhen këto ndryshime:

1. Fjalja e parë e pikës 2 ndryshohet si më poshtë:
“Në rastin e autorizimit me kushte dhe detyrime, afati i përcaktuar në pikën 1 të këtij neni shtyhet me 2 muaj, nëse ndërmarrjet pjesëmarrëse angazhohen të marrin masa për eliminimin e kufizimit në mënyrë të ndjeshme të konkurrencës në treg ose në një pjesë të tij, në veçanti, si rezultat i shenjave të krijimit ose të forcimit të pozitës dominuese.”
2. Shkronja “c” e pikës 3 shfuqizohet.

Neni 27

Pas nenit 57 shtohet neni 57/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 57/1
Pe­zullimi i afateve

Afatet e parashikuara në nenet 56 e 57 pezullohen nga komisioni, me vendim, nëse kjo procedurë e thelluar është penguar nga ndërmarrjet pjesëmarrëse.”.

Neni 28

Në nenin 73 bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Shkronjat “a”, “b” dhe “ç” të pikës 1 ndryshohen si më poshtë:

“a) japin të dhëna të pasakta, të paplota ose të rreme në përgjigje të kërkesës ose vendimit të komisionit, sipas nenit 33 pikat 2 e 3 të këtij ligji, ose nuk japin të dhëna brenda afatit kohor, të përcaktuar në vendimin e komisionit apo në kërkesën e sekretariatit, sipas nenit 33 pika 3 të këtij ligji;

b) japin të dhëna të pasakta, të paplota ose të rreme në njoftimet, sipas neneve 12 e 49 të këtij ligji, ose të dhëna dhe dokumente plotësuese të pasakta e të paplota, sipas nenit 55 të këtij ligji;

ç) refuzojnë t’u përgjigjen pyetjeve për faktet dhe, sipas shkronjës “d” të nenit 36 të këtij ligji, japin përgjigje të pasakta, të paplota, të rreme ose pengojnë inspektimin e parashikuar në nenin 36;”.

2. Pas shkronjës “d” shtohet shkronja “dh” me këtë përmbajtje:

“dh) nuk njofton një përqendrim, sipas neneve 10 dhe 12 të këtij ligji.”.

Neni 29

Në nenin 74 bëhen këto ndryshime:

1. Fjalja e parë e pikës 1 ndryshohet si më poshtë:

“Komisioni vendos gjoba, në masën deri në 10 për qind të xhiros së ndërmarrjes, të vitit financiar paraardhës, për çdo ndërmarrje pjesëmarrëse që:”

2. Shkronja “ç” e pikës 1 shfuqizohet.

3. Në shkronjën “d”, pas fjalëve “realizon një përqendrim” shtohen fjalët “i cili ka efekte të kufizimit të konkurrencës në treg”.

4. Pika 2 shfuqizohet.

Neni 30

Në nenin 75, fjalja e dytë e pikës 2 ndryshohet si më poshtë:

“dhe 10 për qind në rastin e xhiros në tregun përkatës të vitit financiar paraardhës të këtyre ndërmarrjeve, sipas nenit 74 të këtij ligji”.

Neni 31

Në nenin 76 pika 1 shkronja “d”, fjalët “sipas nenit 36” zëvendësohen me fjalët “sipas nenit 35”.

Neni 32

Në nenin 78, fjalët “neni 74 pika 1” zëvendësohen me fjalët “nenin 73 pika 1”, si dhe fjalët “nenit 75 pikat 1 e 2” zëvendësohen me fjalët “nenin 74 pika 1”.

Neni 33

Neni 79 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 79

Ankimi

1. Kundër vendimeve të komisionit për vendosjen e sanksioneve mund të bëhet ankim në gjykatë brenda 30 ditëve nga data e marrjes së njoftimit për vendimin.

2. Ankimi nuk pezullon ekzekutimin e vendimit të parashikuar në pikën 1 të këtij neni.”.

Neni 34

Neni 80 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 80

Gjoha e vënë nga Autoriteti i Konkurrencës është titull ekzekutiv dhe ekzekutohet sipas dispozitave të Kodit të Procedurave Civile. Autoriteti i Konkurrencës nuk ka detyrim që të parapaguajë taksën apo tarifën për shërbimin përmbartimor.”.

Neni 35

Pas nenit 84 shtohen nenet 84/1 dhe 84/2 me këtë përmbajtje:

“Neni 84/1

Çështjet, procedurat hetimore dhe kontrollet e përqendrimeve, pavarësisht nga faza në të cilën ndodhen në çastin e hyrjes në fuqi të dispozitave të këtij ligji, do të vazhdojnë t’u nënshtrohen dispozitave të mëparshme deri në dhënien e vendimit përfundimtar të Komisionit të Konkurrencës.

Neni 84/2

Aktet e Autoritetit të Konkurrencës, të kundërshtuara në gjykatë, do të vazhdojnë të gjykohen, duke u bazuar në ligjin dhe në aktet nënligjore që kanë qenë në fuqi në çastin e fillimit të shqyrtimit gjyqësor.”.

Neni 36

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.6696, datë 4.10.2010 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi**

LIGJ

Nr.10 318, datë 16.9.2010

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR. 9720, DATË 23.4.2007 “PËR
AUDITIMIN E BRENDSHËM NË SEKTORIN PUBLIK”**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

VENDOSI:

Në ligjin nr. 9720, datë 23.4.2007 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, bëhen shtesat dhe ndryshimet e mëposhtme:

Neni 1

Kudo në ligj emërtimi “Drejtoria e Përgjithshme e Auditimit” zëvendësohet me emërtimin “Njësia Qendrore e Harmonizimit për Auditimin e Brendshëm”.

Neni 2

Në nenin 3 bëhen këto ndryshime dhe kjo shtesë:

a) paragrafi i parë ndryshohet si më poshtë:

““Auditimi i brendshëm” është një veprimtari e pavarur, që jep siguri objektive dhe këshilla për drejtimin, i projektuar për të shtuar vlerën dhe për të përmirësuar veprimet e njësive publike. Ai e ndihmon njësinë publike për të arritur objektivat e vet, me anën e një mënyre të disiplinuar dhe sistematike për të vlerësuar e për të përmirësuar frytshmërinë e menaxhimit të riskut, proceset e kontrollit dhe të qeverisjes së njësive publike.”.

b) paragrafi i tretë ndryshohet si më poshtë:

““Kontrolli i brendshëm” është një proces integral i sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit, si dhe i auditimit të brendshëm, i vendosur nga titullari i njësive publike, brenda objektivave të saj qeverisë, për të ndihmuar në kryerjen e veprimtarive të njësive publike me ekonomi, efektivitet dhe efikasitet.”.

c) në fund të këtij neni shtohen paragrafët me këtë përmbajtje:

““Kontrolli i Brendshëm Financiar Publik (KBFP)” është i gjithë sistemi i kontrollit të brendshëm, që ushtrohet nga njësia publike, që synon të garantojë se menaxhimi financiar dhe kontrolli i njësive shpenzuese të buxhetit kombëtar (përfshirë edhe fondet e huaja) është në përputhje me legjislacionin përkatës, përkrahjet e buxhetit, si dhe me parimet e menaxhimit financiar të shëndetshëm, me transparencë, me ekonomi, efektivitet dhe efikasitet. Në sistemin e punës së KBFP-së përfshihen të gjitha masat që kanë të bëjnë me kontrollin e të ardhurave, të shpenzimeve, të asetëve dhe detyrimet e Këshillit të Ministrave. Ky sistem kontrolli përfshin, gjithashtu, harmonizimin qendror dhe bashkërendimin e menaxhimit financiar dhe të kontrollit, si dhe të auditimit të brendshëm.

“Menaxhimi financiar dhe kontrolli” është një sistem politikash, procedurash, veprimtarish dhe kontrollesh, të cilat vendosen, mirëmbahen dhe përditësohen, në mënyrë periodike, nga menaxhimi i lartë, si dhe vihen në zbatim nga personeli i njësive publike, me qëllim trajtimin e risqeve për të dhënë siguri të arsyeshme që objektivat e njësive publike të arrihen në përputhje me ligjet me ekonomi, efektivitet dhe efikasitet.

“Angazhimi/detyra e auditimit” i referohet një marrëveshjeje specifike auditimi, detyrave të ndryshme, auditimi ose rishikimi, proceseve dhe veprimtarive, ku përfshihen veprimtari të shërbimit të sigurisë e të konsultimit.”.

Neni 3

Neni 4 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 4

Llojet e veprimtarisë së auditimit të brendshëm

Llojet kryesore të veprimtarisë së auditimit të brendshëm përfshijnë shërbimet e sigurisë dhe shërbimet e konsultimit.

1. Një angazhim/detyrë auditimi për shërbimet e sigurisë zhvillohet në një auditim me bazë sistemi, nëpërmjet auditimit të përputhshmërisë, të performancës, auditimit financiar, auditimit të teknologjisë së informacionit apo nëpërmjet kombinimit të llojeve të ndryshme të auditimit.

2. Një angazhim/detyrë auditimi për shërbimin e konsulencës përfshin veprimtari këshilluese dhe të tjera si këto, si: konsulta, këshilla, ndihmë dhe trajnime, natyra dhe objekti i të cilave miratohen nga titullari i njësisë publike.”.

Neni 4

Neni 7 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 7

Objekti i auditimit të brendshëm

1. Objekt i veprimtarisë së auditimit të brendshëm është kryerja e auditimit të brendshëm të gjitha strukturave, programeve, veprimtarive dhe proceseve, si dhe të njësive shpenzuese të nivelit më të ulët brenda njësisë publike, përfshirë edhe auditimin e njësive që shpenzojnë burimet e Bashkimit European. Veprimtaria e auditimit të brendshëm në sektorin publik synon:

a) mbështetjen e njësive publike për të arritur qëllimet e saj, duke:

i) ndihmuar titullarin të identifikojë dhe të vlerësojë risqet në njësinë publike;

ii) vlerësuar përshtatshmërinë dhe efektivitetin e sistemeve, të strukturave, të vendimeve, të procedurave e të kontrolleve, pra, sistemin e menaxhimit financiar dhe kontrollit, në përgjithësi, duke u fokusuar kryesisht në:

- identifikimin, vlerësimin dhe menaxhimin e riskut nga titullari i njësive publike;

- përputhshmërinë e akteve të brendshme dhe të kontratave me legjisllacionin;

- besueshmërinë dhe gjithëpërfshirjen e informacionit financiar dhe operacional;

- kryerjen e veprimtarive me ekonomi, efektivitet dhe efikasitet;

- ruajtjen e asetëve dhe të informacionit;

- përmbushjen e detyrave dhe arritjen e qëllimeve;

iii) dhënë rekomandime për përmirësimin e veprimtarive të njësive publike;

b) mbështetjen e angazhimeve/kryerjen e detyrave të veçanta të auditimit për dhënien e shërbimeve të sigurisë ose të shërbimeve të konsulencës;

c) mbështetjen e një angazhimi auditimi për shërbimet e sigurisë, që nënkupton dhënien e një vlerësimi objektiv për të dhënat nga audituesi i brendshëm, me qëllim që ai të japë një opinion ose përfundim të pavarur për një proces, një sistem ose një çështje tjetër që mbulohet nga auditimi.

2. Objektivat dhe objekti për çdo angazhim/detyrë auditimi për shërbimet e sigurisë përcaktohen nga drejtuesi i auditimit të brendshëm. Një angazhim/detyrë auditimi kalon nëpër këto faza:

a) planifikimin;

b) kryerjen e kontrolleve;

c) raportimin dhe ndjekjen e veprimtarive pasuese për të monitoruar zbatimin e rekomandimeve të bëra.

3. Një angazhim/detyrë auditimi për shërbime konsultimi ka për qëllim të shtojë vlerën dhe të përmirësojë qeverisjen e njësive publike, menaxhimin e riskut dhe proceset e kontrollit, pa qenë e nevojshme që audituesi i brendshëm të marrë përsipër përgjegjësi menaxheriale. Një angazhim auditimi për shërbime konsultimi bëhet me nismën e titullarit të njësive publike. Objekti dhe objektivat e çdo detyre përcaktohen nga programi i auditimit.”.

Neni 5

Në nenin 9, pika 4 ndryshohet si më poshtë:

“4. Njësitë e auditimit të brendshëm veprojnë sipas nenit 17 të këtij ligji.”.

Neni 6

Në nenin 10 shkronja “b”, fjalët “Zbatimi i sistemit të kontrollit të brendshëm financiar publik në sektorin publik” zëvendësohen me fjalët “zbatimin e auditimit të brendshëm në sektorin publik”.

Neni 7

Në nenin 11, shkronjat “a” e “c” ndryshohen si më poshtë:

“a) krijimin e shërbimeve të besueshme të auditimit të brendshëm, në përputhje me legjislacionin në fuqi, si dhe garantimin e kapaciteteve të duhura për të përmbushur të gjitha kërkesat që parashikon ky ligj dhe përdorimin e tyre me ekonomi, efektivitet dhe efikasitet;

c) ngritjen dhe funksionimin e sistemeve efektive dhe të përshtatshme të menaxhimit financiar e të kontrollit dhe korrigjimin e parregullsive të vërejtura nga auditimet e kryera, si dhe marrjen e masave të duhura ligjore, kur kjo është e nevojshme.”.

Neni 8

Në nenin 14 bëhen këto ndryshime:

a) Shkronja “d” e pikës 1 ndryshohet si më poshtë:

“d) një ekspert në fushën e sistemeve të menaxhimit financiar dhe të kontrollit;”.

b) Pika 2 ndryshohet si më poshtë:

“2. Anëtarët dhe sekretari i Komitetit të Auditimit të Brendshëm emërohen për një periudhë dyvjeçare, me të drejtë rizgjedhjeje. Drejtori i Përgjithshëm i Njesisë Qendrore të Harmonizimit për Auditimin e Brendshëm cakton sekretarin e Komitetit të Auditimit të Brendshëm, i cili duhet të jetë përfaqësues i drejtorisë (strukturës) së metodologjisë në Njësinë Qendrore të Harmonizimit për Auditimin e Brendshëm.”.

c) Në fund të pikës 4 shtohen fjalët “dhe sekretari i Komitetit të Auditimit të Brendshëm”.

Neni 9

Në nenin 15, paragrafi i parë ndryshohet si më poshtë:

“Njësia Qendrore e Harmonizimit për Auditimin e Brendshëm është pjesë e strukturës së Ministrisë së Financave. Struktura dhe përbërja organike e saj miratohen nga Kryeministri dhe njësohen me nivelin e Drejtorisë së Përgjithshme. Ajo harmonizon, bashkërendon punën, monitoron dhe ofron asistencë teknike për njësitë e auditimit të brendshëm të sektorit publik në Republikën e Shqipërisë.”.

Neni 10

Në nenin 16, shkronjat “dh” e “ë” ndryshohen si më poshtë:

“dh) jep opinion dhe rekomandime për zbatimin e standardeve të auditimit të brendshëm në rastet e mosmarrëveshjeve të rëndësishme, ndërmjet audituesve të brendshëm dhe njësive të audituara;

ë) bashkërendon dhe bashkëpunon me Njësinë Qendrore të Harmonizimit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, ndër të tjera, për përgatitjen e raportit vjetor për sistemin e Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik, i cili i paraqitet Ministrit të Financave dhe nëpunësit të parë autorizues.”.

Neni 11

Në nenin 17 titulli ndryshohet në “Organizimi i auditimit të brendshëm”, ndërsa paragrafi i parë dhe ai i dytë riformulohen si më poshtë:

“Veprimtaria e auditimit të brendshëm kryhet nga:

1. Njësia e auditimit të brendshëm, e cila përbëhet nga drejtuesi dhe nga audituesit e brendshëm, që i raporton drejtpërdrejt titullarit të organizatës përkatëse.
2. Audituesit e brendshëm të njësisë së auditimit të një njësie publike tjetër, në bazë të një marrëveshjeje ndërmjet drejtuesve të njësive publike përkatëse.
3. Një funksion auditimi i nënkontraktuar, në përputhje me kriteret e miratuara nga Ministri i Financave e të përcaktuara në bazë të kostos, të cilësisë dhe të përvojës.

Kriteret për ngritjen e njësive të tilla miratohen nga Këshilli i Ministrave, me propozimin e Ministrit të Financave. Të gjitha njësitë shpenzuese të qeverisjes së përgjithshme duhet ose të krijojnë njësitë e auditimit të brendshëm, ose të kenë audituesin e brendshëm, ose të kontraktojnë shërbimin e auditimit.”.

“Njësitë e auditimit të brendshëm kryejnë auditimin në përputhje me kërkesat e këtij ligji dhe me udhëzimet e nxjerra nga Ministri i Financave. Njësitë e auditimit të brendshëm në subjektet e audituara kanë përgjegjësi dhe të drejtën e aksesit të drejtpërdrejtë te niveli më i lartë drejtues brenda njësisë publike të tyre, në përputhje me këtë ligj dhe me procedurat e përcaktuara nga Ministri i Financave. Njësitë e auditimit nuk duhet, në asnjë rast, të kryejnë punë operative për subjektin e audituar.”.

Neni 12

Në nenin 18 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

Pikat 3 dhe 5 ndryshohen si më poshtë:

“3. Kryerja e angazhimeve të auditimit të brendshëm, sipas udhëzimeve dhe metodave të miratuara nga Njësia Qendrore e Harmonizimit për Auditimin e Brendshëm, për të vlerësuar nëse sistemet e menaxhimit financiar dhe të kontrollit, si dhe performanca e njësisë së audituar janë transparente dhe në përputhje me normat e ligjshmërisë, të rregullshmërisë, të ekonomisë, efektivitetit dhe efijencës.”.

“5. Çdo njësi auditimi e subjektit të audituar përgatit raporte, vjetore ose periodike, të cilat i dërgohen Njësies Qendrore të Harmonizimit për Auditimin e Brendshëm dhe përmbajnë të dhëna për:

1. Angazhimet dhe objektin e auditimit, të kryer gjatë periudhës së raportuar, kohëzgjatjen e çdo auditimi dhe, nëse ka pasur shmangie nga plani, arsyet dhe argumentet përkatëse.
 2. Përfundimet për funksionimin e sistemeve të kontrollit brenda njësisë publike, së bashku me rekomandimet për përmirësim.
 3. Veprimet e ndërmarra nga menaxhimi për zbatimin e rekomandimeve, si dhe çdo rekomandim të pazbatuar.”.
- b) Paragrafi i fundit shfuqizohet.

Neni 13

Në nenin 19, shkronjat “b dhe “c” të pikës 2 ndryshohen si më poshtë:

“b) të ketë jo më pak se 5 vjet përvojë pune në fushën e auditimit ose në fusha, si financat, kontabiliteti apo fusha të tjera të lidhura, ashtu siç përcaktohet në shkronjën “a” të këtij paragrafi;

c) kandidatët e përzgjedhur për pozicionin “Drejtor i njësisë së auditimit të brendshëm” duhet të jenë pajisur me dëshminë “Auditues i brendshëm në sektorin publik” dhe të kenë një përvojë pune 5-vjeçare si auditues.”.

Neni 14

Nenet 25 dhe 27 shfuqizohen.

Neni 15

Neni 26 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 26

Marrëdhëniet me Kontrollin e Lartë të Shtetit

Njësia Qendrore e Harmonizimit për Auditimin e Brendshëm bashkëpunon dhe mban komunikim të vazhdueshëm me institucionin e Kontrollit të Lartë të Shtetit. Ky bashkëpunim synon shkëmbimin e informacioneve për sistemin e auditimit dhe dërgimin e raporteve vjetore Kontrollit të Lartë të Shtetit.”.

Neni 16

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.6697, datë 4.10.2010 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi**

LIGJ

Nr. 10 319, datë 16.9.2010

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 8405, DATË 17.9.1998 “PËR
URBANISTIKËN”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

VENDOSI:

Në ligjin nr. 8405, datë 17.9.1998 “Për urbanistikën”, të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Në nenin 49 bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

- a) Në paragrafin e parë, fjalët “leje për vendosje reklamash” hiqen.
- b) Në fund të nenit shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

“Leja për vendosjen e reklamave, në anë të rrugëve, jepet nga KRRT-ja e bashkisë, komunës apo qarkut, në përputhje me parashikimet e Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë, pas marrjes së autorizimit përkatës, nga autoritetit që ka në përgjegjësi administrimi rrugën ku kërkohet të vendosen reklamat. Reklamat duhet të jenë konform specifikimeve teknike të përcaktuara në Kodin Rrugor dhe në rregulloren për zbatimin e tij.”.

Neni 2

Në fund të nenit 54 shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

“Inspektorati ndërtimor e urbanistik i bashkisë/komunës/qarkut dhe/ose INUK-ja i drejtohet, sipas rastit, sekretarive teknike përkatëse të KRRT-së ose KRRTSH-së, me kërkesë të

veçantë, për t'u shprehur, brenda një afati 30-ditor, për volumin shtesë të objektit, që ndërtohet jashtë kushteve të projektit të miratuar në lejen e ndërtimit. Në përfundim të afatit 30-ditor, nëse KRRT-ja ose KRRTRSH-ja nuk shprehet me vendim, atëherë inspektoratit ndërtimor e urbanistik të bashkisë/komunës/qarkut ose INUK-së i lind e drejta për të vazhduar procedurat për prishjen e objektit.”.

Neni 3

Në nenin 75 bëhen këto shtesa:

a) Në fund të paragrafit të parë shtohet një fjali me këtë përmbajtje:

“Shpenzimet e prishjes së objektit dhe të kthimit të truallit në gjendjen e mëparshme realizohen në bazë të vendimit për zhdëmtim, të dhënë nga inspektorati ndërtimor e urbanistik i bashkisë/komunës/qarkut.”.

b) Në fund të paragrafit të fundit shtohet një fjali me këtë përmbajtje:

“Përjashtim nga rastet e prishjes bëhet kur inspektorati ndërtimor e urbanistik i bashkisë/komunës/qarkut çmon mundësinë e konfiskimit të objektit të kundërligjshëm, në favor të shtetit, sipas parashikimeve në kuadrin ligjor në fuqi, vetëm pas marrjes së miratimit teknik, sipas rastit, nga KRRT-ja/ KRRTRSH-ja.”.

Neni 4

Pas nenit 76 shtohet neni 76/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 76/1

1. Subjekti që disponon mjete apo makineri që përdoren në fushën e ndërtimit është i detyruar të mos ofrojë shërbimin e tij, për persona fizikë apo juridikë, të cilët nuk janë të pajisur me leje ndërtimi. Për këtë qëllim, subjekti që disponon mjete apo makineri që përdoren në fushën e ndërtimit, kërkon paraprakisht, nga ndërtuesi, paraqitjen e lejes së ndërtimit.

2. Shkelja e detyrimit të parashikuar në pikën 1 të këtij neni, kur nuk përbën veprë penale, përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet sipas nenit 81 të këtij ligji.”.

Neni 5

Në nenin 81 bëhen këto shtesa:

a) Në paragrafin e katërt, numri “75” hiqet.

b) Në fund të paragrafit të pestë shtohet një fjali me këtë përmbajtje:

“Në rast konstatimi të mosrespektimit të përcaktimeve të parashikuara në nenin 75, vlera e dënimit me gjobë përllogaritet në masën 5 për qind të vlerës së ndërtimit të kryer.”.

c) Në fund të këtij neni shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

“Për shkelje të nenit 76/1, inspektorati ndërtimor e urbanistik i komunës/bashkisë/qarkut vepron si më poshtë:

1. Vendos dënimin me gjobë:

a) në masën 10 000 000 (dhjetë milionë) lekë, për vënien në dispozicion të mjeteve dhe makinerive vetëlëvizëse (transportierë të çdo tipi, makineri të çdo tipi për përgatitjen e betonit, makineri të çdo tipi për pompimin e Ilaçit e betonit, si dhe makineritë e çdo tipi që përdoren në procesin e gërmimit);

b) në masën 100 (njëqind) lekë/m², për vënien në dispozicion të skelave, në varësi të sipërfaqes së mbulimit;

c) në masën 5 000 (pesë mijë) lekë, për vënien në dispozicion të veglave të punës.

2. Vendos sekuestrimin e mjeteve dhe të makinerive për një afat deri në 6 muaj.”.

Neni 6

Në nenin 85, në togfjalëshin “Formularët bashkëngjitur nr.1”, pas numrit “1” shtohet dhe numri “1/1”.

Neni 7

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.6698, datë 4.10.2010 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi**

Formulari 1/1

LIDHJA E OBJEKTIT
ME INFRASTRUKTURËN RRUGORE

OBJEKTI:

1. Lidhja e sheshit të ndërtimit të objektit me rrugën (hyrja – dalja):

Pika e lidhjes

Shënim i autoritetit që administron dhe mirëmban rrugën

2. Mendimi i zyrës së urbanistikës sipas përkatësisë

Bashkëlidhur formularit: Genplani i sheshit që kërkohet të miratohet për çdo rast dhe studimi përkatës, planimetria dhe prerjet tërthore të hyrje-daljes së objektit që do të ndërtohet në infrastrukturën rrugore, si dhe miratimi i lejes për këtë hyrje-dalje në infrastrukturën rrugore nga autoriteti që administron dhe mirëmban rrugën.

K Ë R K U E S I

(.....)

Datë...../...../20...

VENDIM
Nr.792, datë 6.10.2010

PËR DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.383, DATË 19.5.2010 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURAVE TË SHPËRNDARJES SË FONDIT TË KOMPENSIMIT NË VLERË PËR PRONARËT E PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMET INFORMALE”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 6 e 8 të ligjit nr.10 239, datë 25.2.2010 “Për krijimin e fondit special të kompensimit të pronave”, të nenit 15/1 të ligjit nr.9482, datë 3.4.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr.9235, datë 29.7.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në vendimin nr.383, datë 19.5.2010 të Këshillit të Ministrave bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Shkronja “b” e pikës 2 shfuqizohet.

2. Në pikën 3, fjalët “... dhe vazhdon për 30 (tridhjetë) ditë...” hiqen.

3. Në fjalinë hyrëse të pikës 6, fjalët “... brenda afatit të përcaktuar në njoftimin publik...” hiqen.

4. Pas pikës 6 shtohet pika 6/1, me këtë përmbajtje:

“6/1 Në rastet kur nuk është e mundur të dorëzohet prokura e posaçme, sipas shkronjës “c” të pikës 6, secili bashkëpronar apo një pjesë e tyre, paraqesin kërkesë individuale apo të përbashkët, për pjesën takuese në pronën që kompensohet. Nëse kërkesa paraqitet nga një pjesë e bashkëpronarëve, ajo shoqërohet nga prokura e posaçme e nënshkruar prej tyre, ku si tagër i nevojshëm të jetë edhe e drejta për të tërhequr vlerën financiare, në emër të tyre.

Në rastin e kërkesave individuale të secilit bashkëpronar apo të një pjese të tyre, për çdo aplikim të kryer, paguhet tarifë shërbimi, pavarësisht se i përket së njëjtës pasuri të paluajtshme.”.

5. Në pikën 8 bëhen këto ndryshime:

a) Fjalja hyrëse e pikës 8 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Grupi i punës, sipas pikës 4 të këtij vendimi, brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës, kryen veprimet e mëposhtme:”.

b) Shkronja “d” shfuqizohet.

6. Fjalja hyrëse e pikës 9 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Drejtori i Përgjithshëm i AKKP-së, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e përfundimit të procesit të verifikimit nga grupi i punës.”.

7. Pas pikës 9 shtohet pika 9/1, me këtë përmbajtje:

“9/1 Subjektet përfituese, kërkesa e të cilëve nuk është pranuar për mungesë dokumentacioni gjatë procedurave të mëparshme, kanë të drejtë të riaplikojnë pas plotësimit të mangësive të konstatuara.

Këto subjekte nuk paguajnë tarifë shërbimi, nëse provojnë pagimin e saj gjatë aplikimit të mëparshëm.”.

8. Pika 11 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“11. AKKP-ja realizon ndarjen e fondit të kompensimit të pronave në vlerë proporcionale me masën përkatëse të parashikuar në listat bashkëlidhur vendimeve të Këshillit të Ministrave, që përcaktojnë shpërblimin e pronarëve për pasuri, të cilat preken nga ndërtimet informale, deri në të njëjtën masë të përfituar nga subjektet e kompensuara më parë.”.

II. Ngarkohen Ministria e Drejtësisë dhe Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

UDHËZIM
Nr.17, datë 10.5.2010

**PËR PENSIONET SHTETËRORE SUPLEMENTARE TË PUNONJËSVE TË
UNIVERSITETEVE, TË SHKOLLAVE TË LARTA, QENDRËS SË STUDIMEVE
ALBANOLOGJIKE, AKADEMISË SË SHKENCAVE DHE TË GJITHA INSITUCIONEVE
TË TJERA KËRKIMORE PUBLIKE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË, TË CILËT KANË
TITUJ**

Në mbështetje të nenit 12 dhe 13 të ligjit nr.10139, datë 15.5.2009 “Për pensionet shtetërore suplementare të punonjësve të universiteteve, të shkollave të larta, Qendrës së Studimeve Albanologjike, Akademisë së Shkencave dhe të gjitha institucioneve të tjera kërkimore publike në Republikën e Shqipërisë, të cilët kanë tituj”, Ministria e Financave dhe Ministria e Arsimit dhe Shkencës

UDHËZOJNË:

1. Në zbatim të nenit nr.7, si bazë për llogaritjen e pensionit mujor suplementar për personat e përcaktuar në nenin 2 të ligjit të sipërsënuar janë:

a) Periudha nga data e marrjes së titullit shkencor respektiv, të njohur nga ky ligj dhe deri në datën e lindjes të së drejtës për pension suplementar. Kur e drejta për përfitim suplementar lind pas datës 1.1.2010, periudha e gëzimit të titullit është e vlefshme vetëm në rast se janë paguar kontributet suplementare sipas nenit 4 të ligjit.

b) Paga referuese, e cila është paga bazë mujore, përjashtuar shtesat për funksion, që zbatohet për të njëjtin titull në momentin kur personi ka plotësuar kushtet e përfitimit, sipas nenit 6 të ligjit të sipërsënuar.

2. Në zbatim të nenit nr.11 dhe 12 të ligjit, llogaritja, caktimi dhe pagesa e përfitimeve suplementare bëhet nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore. Përfitimet suplementare për personat me tituj shkencorë, jepen me kërkesën e të interesuarit, i cili paraqet në drejtorinë rajonale të sigurimeve shoqërore përkatëse, dokumentacionin, si më poshtë:

a) Kërkesa për pension suplementar, sipas modelit bashkëlidhur;

b) Një fotokopje e kartës së identitetit e nënshkruar nga personi i interesuar, me emër, mbiemër, firmë dhe me adresën e vendbanimit ose certifikatë personale me fotografi;

c) Fotokopje e noterizuar e dëshmisë për shenjën e titullit;

d) Vërtetim për tituj shkencorë, lëshuar nga Komisioni i Kualifikimit Shkencor;

e) Vërtetim nga qendra e punës për kontributet suplementare të paguara nga data 1.1.2010 dhe deri në datën e lindjes të së drejtës.

Formulari i kërkesës për pension (a) dhe vërtetimi për kontributet e paguara (e) gjendet në agjencinë e sigurimeve shoqërore të qytetit ku i interesuari ka vendbanimin.

Për çdo përfitues, drejtoria rajonale e sigurimeve shoqërore krijon një dosje me dokumente. Rregullat e pranimit të dokumenteve, regjistrimit të kërkesës për përfitim suplementar, plotësimit të dosjes së pensionit me vërtetime të brendshme që lëshohen nga strukturat e sigurimeve shoqërore, rregullat dhe procedurat e plotësimit të vendimit të caktimit të përfitimit, të plotësimit të kartelës financiare dhe urdhërpagesës, veprimet për ndryshimin, pezullimin, mbylljen apo transferimin e përfitimit, janë të njëjta me ato të përcaktuara nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore në rregulloren

nr.3, datë 15.8.1996 “Për caktimin, administrimin dhe pagimin e përfitimeve suplementare shtetërore”.

3. Në zbatim të nenit nr.4 të ligjit:

a) Kontributet suplementare për subjektet e këtij ligji, 3.5 për qind të pagës bruto mujore, për personat me titull të punësuar në institucione publike dhe 7 për qind të pagës bruto mujore, për personat me titull të punësuar në institucione jopublike, derdhen në llogaritë e drejtorive rajonale të Institutit të Sigurimeve Shoqërore, çdo muaj, me të njëjtat rregulla dhe në të njëjtat afate, si edhe sigurimi i detyrueshëm shoqëror.

b) Kontributi suplementar i përcaktuar mbahet nga paga e personit që gëzon titullin dhe ushtron veprimtari ekonomike. Institucioni ku personi është i punësuar është përgjegjës për llogaritjen, ndalesën nga paga dhe xhirimin e shumës së kontributit në llogaritë bankare të adresuara. Në të njëjtën kohë me xhirimin e kontributeve, institucioni publik ose jopublik dërgon në drejtorinë rajonale të sigurimeve shoqërore përkatëse edhe informacionin individual për çdo kontributpagues i cili modelohet në formën e një formulari, ku shënohen: numri i sigurimit/identifikimit; emri, mbiemri; titulli; funksioni ose detyra aktuale; paga bruto; kontributi mujor për çdo person. Në këtë formular regjistrohet edhe banka ku është bërë derdhja e kontributit, data dhe shuma e kontributit të transferuar, nënshkruhet nga drejtuesi i autorizuar i subjektit, i vihet vula dhe i bashkëlidhet transferues ose dërgohet drejtpërdrejt në drejtorinë rajonale të sigurimeve shoqërore përkatëse. Ky informacion do të shërbejë për çeljen e kartelave individuale të kontributeve suplementare të paguara nga çdo person.

c) Institucionet jopublike, në të cilat punësimi konsiderohet periudhë e ushtrimit të titullit, janë universitetet dhe shkollat e larta të akredituara.

d) Detyrimi për të paguar kontribute fillon nga data 1.1.2010. Subjektet punëdhënëse të personave me tituj dhe Instituti i Sigurimeve Shoqërore të marrin masa për derdhjen e kontributeve të prapambetura nga 1.1.2010 deri në daljen e këtij udhëzimi dhe në vazhdim.

4. Programi i të ardhurave nga kontributet dhe i volumit të transfertës nga Buxheti i Shtetit, për mbulimin e shpenzimeve të kësaj skeme, ndjek të njëjtat rregulla, procedura dhe afate, si edhe për programimin e buxhetit të Institutit të Sigurimeve Shoqërore.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI I FINANCAVE
Ridvan Bode

MINISTRI I ARSIMIT DHE SHKENCËS
Myqerem Tafaj

Modular P-10139-03

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
(EMRI I SUBJEKTIT QË LËSHON VËRTETIMIN)

Nr. _____prot

Tiranë më _____

VËRETIM

MBI PAGËN REFERUESE NË ZBATIM TË LIGJIT NR.10139, DATË 15.5.2009

Me anën e të cilit vërtetojmë se znj./z. _____

emër atësia mbiemri

ka përfituar pagë referuese sipas pikës 4 të nenit 2 të ligjit nr.10139, datë 15.5.2009 si më poshtë vijon:

Nr.	Përshkrimi i vendeve të punës	Periudha		Paga referuese për këtë titull në datën
		Fillim	Mbarim	
I	Profesor ose drejtues kërkimesh			
1				
2				
3				
4				
5				
II	Profesor i asociuar ose mjeshtër kërkimesh			
1				
2				
3				
4				
5				

E lëshojmë këtë vërtetim për ta paraqitur pranë strukturave të sigurimeve shoqërore në mbështetje të pikës 4 të nenit 2 të ligjit nr.10139, datë 15.5.2009.

ADMINISTRATORI

Vula

Modular P-10139-04

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
 MINISTERIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS
 KOMISIONI I VLERËSIMIT TË TITUJVE AKADEMIKË

Nr. _____ prot _____ me _____

VËRTETIM

Me anën e të cilit vërtetojmë se znj./z. _____ / _____ / _____
 emër atësi mbiemër

ka fituar titullin:

1. “Profesor” sipas vendimit nr. _____ datë _____ / _____ me numër regjistri themeltar nr. _____
2. “Profesor i asociuar” sipas vendimit nr. _____ datë _____ / _____ / _____ me numër regjistri themeltar nr. -----
3. “Drejtues kërkimesh” sipas vendimit nr. _____ datë _____ / _____ / _____ me numër regjistri themeltar nr. -----
4. “Mjeshtër kërkimesh” sipas vendimit nr. ----- datë -----/-----/----- me numër regjistri themeltar nr. _____

Lëshohet ky vërtetim në mbështetje të ligjit nr.10 139, datë 15.5.2009 “Për pensionet shtetërore suplementare të punonjësve të universiteteve, të shkollave të larta, Qendrës së Studimeve Albanologjike, Akademisë së Shkencave dhe të gjitha institucioneve të tjera kërkimore publike në Republikën e Shqipërisë, të cilët kanë tituj shkencorë”, për ta paraqitur pranë drejtorisë rajonale të sigurimeve shoqërore, ku ka vendbanimin.

PËR KOMISIONIN E KUALIFIKIMIT SHKENCOR

Vula

7427

URDHËR
Nr.2815/2, datë 16.8.2010

PËR KUIFJTË E RINJ TË MASAVE ADMINISTRATIVE ME GJOBË

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës, të pikës 3 të ligjit nr.8378, datë 22.7.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJMË:

1. Vlera e masave administrative me gjobë, në bazë të ndryshimit të indeksit të çmimeve të konsumit për dy vitet paraardhëse (2008 dhe 2009) prej 2.79% është si më poshtë:

Neni, pika	Ishte (lekë)	Bëhet (lekë)
6, 2	2500-10000	2600-10300
6, 12, fjalía e parë	1000-4000	1030-4100
6,12, fjalía e dytë	2500-10000	2570-10300
6, 13	1000-4000	1050-4100
7, 12	1000-4000	1050-4100
7, 13, fjalía e parë	500-2000	520-2050
7, 13, fjalía e fundit	250-1000	260-1030
8, 2	1000-4000	1030-4100
9, 8	5000-20000	5150-20600
	10000-40000	10300-41100
9, 9	2500-10000	2600-10300
	10000-40000	10300-41100
10, 17	50000-200000	51400-205600
10, 18	10000-40000	10300-41100
10, 19	2500-10000	2600-10300
10, 20	25000-100000	25700-10300
10, 21	25000-100000	25700-10300
15, 2	2500-10000	2600-10300
19, 2	10000-40000	10300-41100
20, 4	25000-100000	25700-10300
21, 4	10000-40000	10300-41100
22, 11	10000-40000	10300-41100
22, 12	2500-10000	2600-10300
23, 11	25000-100000	25700-102800
24, 6	5000-20000	5150-20600
24,7	2500-10000	2600-10300
25, 2	2500-10000	2600-10300
25, 5	50000-200000	51400-205600
27, 11	10000-40000	10300-41100
29, 3	10000-40000	10300-41100
33, 7, fjalía e parë	25000-100000	25700-102800
33, 7, fjalía e dytë	10000-40000	10300-41100
34, 5	500-2000	510-2050
38, 12	10000-40000	10300-41100
45, 6	25000-100000	25700-102800
45, 8	50000-200000	51400-205600
51, 2	250-1000	260-1030
63, 5	5000-20000	5150-20600
65, 2	1000-4000	1030-4100
67, 5	1000-4000	1030-4100
67, 6	5000-20000	5150-20600
68, 4	500-2000	510-2060
70, 4, fjalía e parë	5000-20000	5150-20600
70, 4, fjalía e dytë	500-2000	510-2060
71, 5, fjalía e parë	500-2000	510-2060
71, 5, fjalía e dytë	100000-200000	102800-205600
72, 12	5000-20000	5150-20600
73, 3	5000-20000	5150-20600
74, 6	25000-100000	25700-102800
75, 8	50000-200000	51400-205600
76, 3	50000-200000	51400-205600

Neni, pika	Ishte (lekë)	Bëhet (lekë)
77, 3	25000-100000	25700-102800
78, 4	5000-10000	5150-10300
79, 10, fjalia e parë	2500-10000	2600-10300
79, 10, fjalia e dytë	100000-200000	102800--205600

Neni, pika	Ishte (lekë)	Bëhet (lekë)
79, 10, paragrafi i dytë	1000-5000	1030-5150
79, 11	25000-100000	25700-102800
81, 8	5000-20000	5150-20600
82, 4	10000-40000	10300-41100
83, 5	25000-100000	25700-102800
	2500-10000	2600-10300
83, 4	10000-40000	10300-41100
	25000-100000	25700-102800
84, 4	10000-40000	10280-41100
	25000-100000	25700-102800
85, 2	10000-100000	10300-102800
85, 3	5000-20000	5150-20600
86, 6	25000-100000	25700-102800
87, 3	25000-100000	25700-102800
89, 2	25000-100000	25700-102800
92, 6	25000-100000	25700-102800
92, 7	5000-20000	5150-20600
92, 8	10000-40000	10300-41100
93, 3	10000-40000	10300-41100
93, 4	5000-20000	5150-20600
94, 4	5000-20000	5150-20600
96, 5	5000-20000	5150-20600
96, 6	2500-10000	2600-10300
96, 7	2500-10000	2600-10300
96, 9	1000-4000	1030-4100
97, 3, paragrafi i parë	5000-20000	5150-20600
97, 3, paragrafi i dytë	10000-40000	10300-41100
98, 3	2500-10000	2600-10300
98, 4	5000-20000	5150-20600
99, 11	5000-20000	5150-20600
99, 13	1000-4000	1030-4100
99, 14	25000-100000	25700-102800
100, 3	25000-100000	25700-102800
101, 6	5000-20000	5150-20600
101, 7	2500-10000	2600-10300
102, 5, fjalia e parë	10000-40000	10300-41100
102, 5, fjalia e dytë	25000-100000	25700-102800

Neni, pika	Ishte (lekë)	Bëhet (lekë)
103, 10	10000-40000	10300-41100
103, 11	2500- 10000	2600-10300
104, 4	10000-40000	10300-41100
107, 6	25000-100000	25700-102800
108, 4	25000-100000	25700-102800
108, 5	2500- 10000	2600-10300
109, 6, fjalia e parë	10000-40000	10300-41100
109, 6, fjalia e dytë	2500-10000	2600-10300
110, 6	1000-4000	1030-4100
111, 4	5000-10000	5150- 10300
115, 11	25000-100000	25700-102800
115, 12	25000-100000	25700-102800
115, 13	2500-10000	2600-10300
115, 14	5000-20000	5150-20600
115, 15	2500-10000	2600-10300
116, 10, 11	10000-40000	10300-41100
116, 12	5000-20000	5150-20600
120, 4	5000-20000	5150-20600
120, 7	25000-100000	25700-102800
120, 8 fjalia e parë	25000-100000	25700-102800

Neni, pika	Ishte (lekë)	Bëhet (lekë)
120, 8 fjalja e fundit	5000-20000	5150-20600
121, 11	50000-200000	51400-205600
121, 12	10000-40000	10300-41100
122, 4	2500-10000	2600-10300
123, 3	10000-40000	10300-41100
123, 4	10000-40000	10300-41100
124, 7	10000-40000	10300-41100
126, 2	5000-20000	5150-20600
130, 5	5000-20000	5150-20600
132, 2	5000-20000	5150-20600
133, 4	10000-40000	10300-41100
139, 8	10000-40000	10300-41100
139, 9	250-1000	260-1030
139, 10	500-2000	510-2060
140, 7	500-2000	510-2060
140, 8	1000-4000	1030-4100
140, 9	2500-10000	2600-10300
140, 10	250-1000	260-1030
141, 10	1000-4000	1030-4100
141, 11	500-2000	510-2060
142, 4	500-2000	510-2060
143, 10	500-2000	510-2060
144, 2	500-2000	510-2060
144, 3	5000-20000	5150-20600
145, 5	500-2000	510-2060
146, 15	500-2000	510-2060
146, 16 fjalja e parë	500-2000	510-2060
146, 16 fjalja e dytë	1000-4000	1030-4100
147, 4	500-2000	510-2060
147, 5	5000-20000	5150-20600
148, 4	2500- 10000	2600-10300
150, 3	500-2000	510-2060
151, 10	10000-40000	10300-41100
151, 11	500-2000	510-2060
152, 7	500-2000	510-2060
153, 5	1000-4000	1030-4100
154, 5	500-2000	510-2060
155, 8	500-3000	510-3090
156, 6	500-3000	510-3090
158, 2	250-1000	260-1030
159, 4, fjalja e parë	500-2000	510-2060
159, 4 , fjalja e dytë	5000-20000	5150-20600
160, 5	500-2000	510-2060
161, 3	1000-4000	1030-4100
162, 8	500-2000	510-2060
163, 3	500-2000	510-2060
164, 2	250-1000	260-1030
165, 2a	500-2000	510-2060
165 , 2b	1000-4000	1030-4100
165 , 2c	2500-10000	2600-10300
165 , 2d	10000-40000	10300-41100
165, 7	10000-40000	10300-41100
166, 7	50000- 200000	51400-205600
166, 8	50000- 200000	51400-205600
166, 9	50000- 200000	51400-205600
170, 8	250-1000	260-1030
170,9	250-1000	260-1030
170,10	10000-40000	10300-41100
171, 3	250-1000	260-1030
172, 2	5000-20000	5150-20600
173, 13	2500-10000	2600-10300
173,14	500-2000	510-2060
173, 15	2500-10000	2600-10300
173,16	250-1000	260-1030
174, 17	2500-10000	2600-10300
175, 3	10000-40000	10300-41100
175, 4	5000-20000	5150-20600
176, 3	500-2000	510-2060
176,5	5000-20000	5150-20600

Neni, pika	Ishte (lekë)	Bëhet (lekë)
177, 2	10000-40000	10300-41100
177, 3	10000-40000	10300-41100
178, 7	250-1000	260-1030
178, 8	2500-10000	2600-10300
179, 3	250-1000	260-1030
180, 10, fjalia e parë	250-1000	260-1030
180, 10 fjalia e dytë	500-2000	510-2060
181, 5	250-1000	260-1030
182, 8	500-2000	510-2060
183, 6	500-2000	510-2060
184, 2	2500-10000	2600-10300
184, 5	5000-20000	5150-20600
186, 4	500-2000	510-2060
186, 5	250-1000	260-1030
187, 6	1000-4000	1030-4100
187, 8	5000-20000	5150-20600
187, 10	1000-4000	1030-4100
189, 4	500-2000	510-2060
190, 6	1000-4000	1030-4100
190, 7	5000-20000	5150-20600
191, 2	10000-40000	10300-41100
200	5000	5150
212, 6	10000-40000	10300-41100
213, 5	10000-40000	10300-41100
214, 5	10000-40000	10300-41100

2. Ky urdhër botohet në Fletoren Zyrtare dhe zbatohet duke filluar nga 1 janar 2011.

**MINISTRI I PUNËVE PUBLIKE
DHE TRANSPORTIT
Sokol Olldashi**

**MINISTRI I
BRENDSHËM
Lulzim Basha**

**MINISTRI I FINANCAVE
Ridvan Bode**

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi "Gjergj Fishta", mbrapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", tel: 04 24 27 003.

Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2010 është 16 000 lekë.

Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

KODI PENAL	226 lekë
KODI I PROCEDURËS PENALE.....	330 lekë
PËRMBLEDHJE E AKTEVE NDËRKOMBËTARE PËR DREJTËSINË	660 lekë
PËRMBLEDHJE PËR KTHIMIN DHE KOMPENSIMIN E PRONAVE	140 lekë
PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR PASURITË E PALUAJTSHME	328 lekë
PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR SHOQËRITË TREGTARE	260 lekë
VENDIME UNIFIKUESE TË GJYKATËS SË LARTË	512 lekë

Hyri në shtyp më 7.10.2010
Doli nga shtypi më 7.10.2010

Tirazhi: 2300 copë

Formati: 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2010

Çmimi 28 lekë